

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEČE KPI**

**GSK-KPA-A-5/09**

**Prishtinë**

**19 Maj 2011**

Në procedurën e:

**S.D.**

*Parashtruesi i ankesës*

*Kundër*

**Z.S.**

*Paraqitësi i kërkesës /Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Kryetarja e Kolegjit Antoinette Lepeltier-Durel, si dhe nga Gjyqtarët Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KPCC/A/13/2008, (dosja në AKP e regjistruar si KPA36452), më 30 Prill 2008, në seancën gjyqësore me 13 Maj 2011, merrë këtë

## AKTGJYKIM

- 1- Pranohet ankesa e S.D. si e bazuar.
- 2- Anulohet vendimi i KPPK-së KPCC/A/13/2008, vetëm në pjesën që i referohet kërkesës së paraqitur më 7 maj 2007 nga Z.S. të regjistruar me numrin Nr. KPA36452.
- 3- Hedhet poshtë kërkesa e paraqitur më 7 maj 2007 nga Z.S., e regjistruar me numrin Nr. KPA36452.
- 4- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 50 (pesëdhjetë eurosh) duhet të mbulohen nga pala përgjegjëse në ankesë Z.S., dhe t'i paguhen Gjykatës Supreme brenda një afati prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

### Historiku faktik dhe procedural:

Më 7 Maj 2007, Z.S. i lindur D. ka paraqitur kërkesë në AKP duke kërkuar kthimin në posedim të parcelës nr. 2210, të lokalizuar në pjesën e quajtur "Njivçe" Jasenovik, Novobërdë, në sipërfaqe prej 0 ha 16 ari 65 m<sup>2</sup>, si dhe kompensimin për shfrytëzimin e parcelës pa leje.

Ajo ka pohuar se është bashkëpronare e 1/3 pjesë të pronës në fjalë dhe se kjo parcelë është uzurpuar nga persona të panjohur.

Në mbështetje të kërkesës së saj, ajo ka dorëzuar në AKP këto dokumente:

- Fletën poseduese nr. 27 të zonës kadastrave Jasenovik në komunën Novobërdë;
- Vendimin e trashëgimisë T. Nr. 249/89, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, më 10 janar 1990;
- Çertifikatën e martesës me M.S. emrin e të cilit nuk kemi mundur ta kuptojmë (ka qenë i palexueshëm).

Në mbështetje të pohimit të saj ajo ka dhënë edhe emrat e personave fizikë S.D. dhe J.D..

Në raportin e saj mbi njoftimin, AKP-ja ka konstatuar se parcela në fjalë ishte uzurpuar, por edhe pse ishin pyetur disa banorë të fshatit, nuk ka mundur ta identifikojë uzurpuesin i cili nuk ka qenë i pranishëm. Njoftimi mbi kërkesën është plotësuar më 17 Janar 2008 por nuk i është adresuar askujt. AKP-ja ka proceduar me njoftimin e kërkesës duke vendosur një afishe për parcelën më 4 mars 2008, por pasi që asnjë palë e paditur nuk është përgjigjur brenda afatit ligjor, kërkesa është konsideruar si e pakontestuar.

Raporti i vërtetimit nga AKP-ja ka vërtetuar vlefshmërinë e fletës poseduese dhe vendimin mbi trashëgiminë në Departamentin e Kadastrës dhe në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Sipas kësaj të fundit, është thënë se ky vendim nuk ka qenë i vulosur në mënyrë të zyrtare por asnjë ankesë nuk është paraqitur kundër tij.

Me vendimin e datës 30 Prill 2008, KKPK ka vendosur që paditësi ishte pronar i 1/3 së pronës së kërkuar dhe ka urdhëruar që asaj t'i kthehej pronësia e kësaj pasurie dhe se kushdo që e ka uzurpuar atë duhet ta lirojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas marrjes së vendimit. KPPK-ja ka hedhur poshtë kërkesën për kompensim të dëmit fizik ose të humbjes së drejtës në shfrytëzim, pasi që këto nuk binin nën kompetencat e saj.

Paditësi ka pranuar vendimin e KPPK-së më 12 Shkurt 2009 dhe ka paraqitur kërkesën për kthimin e e të drejtës së pronësisë më 19 Mars 2009. Më vonë, ky vendim i është dorëzuar personit S.D., uzurpuesit aktual të parcelës, më 12 Maj 2009.

Më 9 Qershor 2009, S.D. (tash e tutje paraqitësi i ankesës) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të sipërpërmendur.

Në ankesën e vet, ai ka deklaruar se vendimi i ankimuar përmbante shkelje esenciale, zbatim të gabuar të ligjit material dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke theksuar se vendimi ankimor ishte marrë duke mos marrë fare në konsideratë padinë e deponuar para Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Në mbështetje të ankesës së vet, ai ia ka ofruar Gjykatës Supreme kërkesëpadinë të cilën e kishte paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë së bashku me personat S.D., Z.D. dhe S.D. kundër Ž.S., S.K. dhe J.D., si dhe diagramin e anëtarëve të familjes të tij.

Në këtë kërkesë, paditësit kanë sqaruar se, mes tjerash, ngastra në fjalë ka qenë pronë e të ndjerit S.D., gjysh i të dy paditësve dhe i dy të paditurve të parë, pastaj vjehërr i të paditurit të tretë, se gjyshi kishte gjashtë fëmijë dhe se nuk ishte kryer procedura e trashëgimisë pas vdekjes së tij. Ata shtuan se kjo ngastër ishte regjistruar në mënyrë të kundërligjshme në emër të njërit prej fëmijëve të gjyshit, tash të ndjerit S.D., të cilin e kishin trashëguar pastaj gruaja J.D. si dhe dy vajzat e tyre Ž.S. dhe S.K.. Ato kanë kërkuar që të njihen si bashkëpronare të ngastrës si trashëgimtare të babait të tyre të ndjerë J.D., i cili është një fëmijë tjetër i gjyshit të tyre.

Duke iu përgjigjur kërkesës së saj, Gjykata Komunale në Prishtinë ia ka ofruar Gjykatës Supreme vendimin e saj P. Nr. 1935/08 të nxjerrë më 25 maj 2010 me të cilin kërkesa është hedhur poshtë. Ky vendim ka të bëjë me shumë ngastra të tokës dhe në versionin shqip, në veçanti ngastrës në fjalë edhe pse përkthimi në gjuhën angleze nuk e përmend fare këtë.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankesë. Procedura ankimore ende nuk ka përfunduar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Pala përgjegjëse në ankesë ka marrë ankesën kundër vendimit të KKPK-ës me 23 Tetor 2009, por nuk ka dorëzuar kurrfarë përgjigje.

### **Arsyetimi ligjor:**

Vendimi i shkallës së parë i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 12 Maj 2009. Sipas Nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave të cilat lidhen me pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit mbi vendimit. S.D. ka dorëzuar ankesë me kohë më datën 9 Qershor 2009.

Ankuesi kundërshton vendimin e KKPK-së për arsye nuk ka marrë parasysh padinë e ngritur para gjoja gjykatës kompetente në Prishtinë.

Në mënyrë të qartë, ankuesi kërkon nga Gjykata që të merr parasysh procedurën e hapur në gjykatat e rregullta si një çështje të dëmshme e cila ka penguar KKPK-në në nxjerrjen e vendimit të saj.

Gjykata Supreme konstaton se AKP-ja pa sukses është munduar që ta identifikojë uzurpuesin e tanishëm të ngastrës në fjalë dhe se mungesa e të paditurit para KKPK-së pas njoftimit të kërkesës për këtë ngastër, ka çuar tek shqyrtimi i kërkesës së pakundërshtuar.

Vetëm kur është dorëzuar vendimi i KKPK-së, personi S.D. është identifikuar si uzurpatori i tanishëm i ngastrës dhe të njëjtit i është dërguar edhe vendimi i KKPK-së.

Për këtë arsye, KKPK-ja nuk ka mundur të dijë se ekziston edhe çështja e pazgjidhur në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Pasiqë vetëm tani nga vet ankesa është kuptuar se është duke u zhvilluar një procedurë gjyqësore pranë gjykatave të rregullta, Gjykata Supreme shqyrton të dy paditë paralele. Ajo vëren se të dyja procedurat para KKPK-së dhe para Gjykatës Komunale të Prishtinës bazohen në trashëgiminë. Nga njëra anë, paditësja Z.S. ka dorëzuar në KKPK vendimin e trashëgimit të ku shkruan se ajo është një nga trashëgimtarët e babait të saj të ndjerë S.D..

Ky vendim mbi trashëgiminë është konsideruar i vlefshëm nga KKPK-ja dhe nuk është kundërshtuar drejtpërdrejt nga ankuesi. Nga ana tjetër, ankuesi së bashku me vëllezërit dhe motrat e veta ka paraqitur kërkesën para Gjykatës Komunale të Prishtinës, duke kërkuar që ajo të vendosë se babai i tyre i ndjerë J.D., ka qenë njëri prej trashëgimtarëve të gjyshit të tyre S.D., si dhe se ngastra në fjalë nuk është dashur të regjistrohej vetëm në emrin e të ndjerit S.D..

Është e vërtetë se nëse në këtë rast gjykatat e rregullta do të kishin nxjerrë vendimin e formës së prerë mbi pranimin e kësaj kërkesë, atëherë një vendim i tillë do të kishte ndikim në të drejtën pronësore të Z.S., ose së paku në atë masë sa që të ishte në kundërshtim me vendimin e KKPK-së.

Megjithatë, dokumentet e dorëzuara nga apeluesi dhe shkresat e lëndës së Gjykatës Komunale të Prishtinës, kopjet e të cilave i janë dërguar edhe Gjykatës Supreme, kanë çuar gjykatën që ta ngritë sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencave të KKPK-së mbi lëndën.

Sipas Nenit 365 të Ligjit mbi procedurën kontesimore (Gazeta zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596) (që zbatohet në këtë procedurë sipas Nenit 533.1 të Ligjit nr. 03/L-006 mbi procedurën kontesimore dhe se i njëjti ligj ka hyrë në fuqi më 5 Tetor 2008, pra pas nxjerrjes së vendimit mbi KKPK-në), gjykata e shkallës së dytë duhet t'i shqyrtojë sipas detyrës zyrtare shkeljet esenciale lidhur me shkeljen e nenit 354, par. 2, nënparagrafi 3 dhe 4 të të njëjtit ligj. Kjo shkelje ka të bëjë me jokompetencën lëndore të gjykatës së shkallës së parë.

Kompetencat e KKPK-së janë të përcaktuara me Nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, i cili parasheh që KKPK-ja ka kompetenca për t'i zgjidhur *“kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:*

*(a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; dhe*

*(b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,*

*ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.”*

Gjykata Supreme konsideron se kushti “të lidhura me konfliktin” nuk plotësohet në këtë lëndë dhe si pasojë e asaj që KKPK-ja nuk ka pasur kompetenca mbi këtë lëndë.

Në raportin e vet të përpunimit të kërkesës, të datës 7 Prill 2008, AKP-ja ka konstatuar se data e humbjes së pronësisë nga Z.S. ka qenë data 12 Qershor 1999 dhe se uzurpuesi i tanishëm i ngastrës së diskutueshme nuk është identifikuar.

Megjithatë, uzurpuesi i tanishëm më vonë është identifikuar si kushëri i personit Z.S.. Për më tepër procesverbali i shqyrtimit të mbajtur në Gjykatën Komunale më 20 Prill 2010 tregon se Z.S. i është përgjigjur pyetjes së Gjyqtarit se ajo kurrë nuk ishte trazuar nga paditësit apo nga dikush tjetër sa i përket pronësisë apo shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme. Mbrojtja nga paraqitjet e datës 28 Nëntor 2008, nga ana e saj me të ëmën dhe të motrën dhe nga dëshmia e paditësve të përmendur në vendimin e lëshuar nga Gjykata Komunale më datën 25Mmaj 2010 sjellin prova se leja për shfrytëzimin e shtëpisë dhe për punimin e tokës kushëririt të tyre i ishte dhënë nga të paditurit ose së paku nga njëri prej tyre.

Nga këto fakte, duket se mosmarrëveshja në mes të anëtarëve të së njëjtës familje ka pasur një histori të gjatë dhe se origjina e saj nuk ka asgjë të përbashkët me konfliktin e armatosur, i cili ka ndodhur në mes të 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999.

Fakti që Z.S. ka braktisur Kosovën më datën 12 Qershor 1999 nuk do të thotë domosdoshmërisht se uzurpimi i ngastrës së saj nga ana e kushëririt lidhet me këtë konflikt të armatosur.

Formulimi i Nenit 3.1 *“të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërdrejtë janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur”* nënkupton një lidhje të drejtpërdrejtë në mes të shpronësimit dhe konfliktit të armatosur ose një lidhje të ngushtë të shkakut dhe pasojës, që në rastin konkret është duke munguar. Kjo çështje juridike të ronësisë në palujtshmërinë e thaksuar i referohet një çështjeje të trashëgimisë që është sajuar në mënyrë të pavarur nga rrethana e konfliktit që ka ndodhur në Kosovë.

Kjo analizë vërtetohet edhe me faktin që, posa të zgjidhet përfundimisht çështja e trashëgimisë, atëherë edhe e drejta e pronësisë mbi ngastrën në fjalë do të zgjidhet me fitimin e së drejtës së pronësisë nga Z.S..

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, Gjykata Supreme konstaton se kërkesa e parashtruar nga Z.S. në KKPK nuk hyn në kompetencat e KKPK-së. Për këtë arsye, vendimi i apeluar nuk mund të qëndrojë prandaj duhet të anulohet. Për më tepër, sjellja e vendimit të ri me ndryshimin që vjen si pasojë e vendimit të KKPK-së, të përcaktuar me Nenin 13.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Gjykata Supreme vendos që kërkesa e bërë në KKPK duhet të hedhet poshtë pasi që nuk bie në kompetencat e këtij Komisioni. Duke pasur parasysh se çështja ligjore e ngritur me kërkesë do të gjykohet përmes procedurës së hapur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e njëjta nuk ka nevojë që t'i referohet një gjykate të rregullt.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Sipas Nenit 8.4 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës pranë Sekretariatit ekzekutiv ose Komisionit, në favor apo kundër ndonjë pale në procedurë .

Megjithatë, ky lirim nuk parashihet për procedurën pranë Gjykatës Supreme

Si rezultat i kësaj, zbatohet regjimi i rregullt i shpenzimeve gjyqësore i përcaktuar me Ligjin mbi shpenzimet gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 3, tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me unifikimin e shpenzimeve gjyqësore, edhe për procedurën pranë Gjykatës Supreme.

Kështu, në këtë procedurë të apelit zbatohen këto shpenzime gjyqësore:

- Tarifa e taksës gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA nr. 2008/2): në vlerë prej 30 €
- Tarifa e taksës gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA nr. 2008/2), duke marrë parasysh faktin që vlera e pasurisë në fjalë vlerësohet të jetë në mes 1.001 dhe 2.500 €: në vlerë prej 20 €.

Këto shpenzime gjyqësore duhet të barten nga pala përgjegjëse në ankesë e cila e humb rastin.

Sipas Nenit 46 të Ligjit mbi shpenzimet gjyqësore, afati për pagesën e shpenzimeve nga personi që banon jashtë vendit nuk mund të jetë më pak sesa 30 ditë dhe jo më shumë sesa 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në këtë rast, shpenzimet gjyqësore të paguhen nga parashtruesi i ankesës në afat prej 90 ditësh që nga dita e marrjes së aktgjykimit.

### **Udhëzim juridik**

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet as me mjete të zakonshme as të jashtëzakonshme juridike.

**Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit të EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Regjistruer i EULEX-it.**